

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
KESHILLI KOMBETARE I UJIT  
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

V E N D I M

Nr. 1 Date 06.04.2010

“PER  
MIRATIMIN E AUTORIZIMIT TE POSACEM  
PER PERDORIM TE REZERVES UJORE  
PER PRODHIM HIDROENERGJIE.

Bazuar ne piken 9, kreu XI, “Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates”, i vendimit nr. 87, dt. 16.01.2008 te K.M. “Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M.”, “Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve”, te ndryshuar, dhe nenit 18 germa dh, te ligjit nr.8093 dt. 21.06.1996 “Per rezervat ujore”, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

V E N D O S I :

- 1- MIRATIMIN e Autorizimit te posacem per Perdorim te Rezerves Ujore te Perroit te Trebishtit, komuna Trebisht, rrethi Bulqize, per HEC -1, HEC -2 dhe HEC -2A per prodhim hidroenergjie, subjektit “SA- GLE KOMPANI”sh.p.k dhe “ERNIKU “ sh.p.k. e cila ka nenshkruar Kontraten e Koncesionit me autoritetin kontraktues me date 14.09.2009, bazuar ne miratimin e marre ne V.K.M.nr.707 dt. 07.07.2008, mbasi subjekti ka depozituar prane A.U.B. Drin-Bune kerkesen dhe kopjen e Kontrates se Koncesionit per HEC-et qe do te ndertojne.
- 2- Perdorimi i rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Tarifa per leshimin e lejes do te behet sipas pikes 3 te vendimit nr. 13 dt. 09.08.2006 te K.B.U. Drin-Bune.
- 4- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PERGJEGJESI I A.U.B.

KRYETARI I K.B.U.

DRIN-BUNE  
Xhelal BAJRAKTARI



DRIN-BUNE  
Maxhid CUNGU

